

OJQ "YAHR" evidencën jofunksionalitet komitetesh komunale

Arian Duriqi

LIPJAN, 5 QERSHOR - OJQ YAHR (Youth Association for Human Rights), teksa ka publikuar raportin e monitorimit të punës së KK të Lipjanit gjatë periudhës janar - qershor 2014, ka evidencuar ngërc të madh në funksionimin e komiteteve në kuadër të KK-së. Me përjashtim të Komitetit të Politikës e Financave (KPF), ndërkaq, komitetet e tjera janë "paralizuar".

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i "YAHR"-it, është shprehur me këtë rast se monitorimi është fokusuar në KK dhe organe të tjera të këtij kuvendi, derisa, sipas tij, raporti përmban edhe analiza cilësore të legjislacionit në fuqi dhe praktika më të mira për vetëqeverisjen lokale, të cilat përdoren në lidhje me gjetjet dhe përgjegjësitë e Komunes. E mosfunksionimi i komiteteve, sipas tij, ka kaluar çdo kohë për normalizim të tyre.

"Në hulumtimin e kryer kemi konstatuar joefikasitet të punëve të komiteteve të formuara me përjashtim të KPF-së dhe ky fakt nuk çon në drejtim të mirë të demokracisë, përkundrazi e ngufat atë", ka thënë Krasniqi.

Në hartimin e këtij raporti, të nëntin monitorues për punën e KK-së, YAHR është mbështetur në shumë burime informacioni, në monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, në monitorimin e seancave të KK-së, por edhe në drejtimin e KPF-së. Ndërkohë që, sipas Krasniqit, nuk kanë mbetur anash as analizat e



Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i "YAHR"-it ka theksuar se në hulumtimin e kryer ka pasur joefikasitet të punëve të komiteteve të formuara me përjashtim të KPF-së dhe ky fakt nuk çon në drejtim të mirë të demokracisë"

dokumente të ndryshme, debatet dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile. E Krasniqi, që prej vitësh drejton OJQ-në YAHR, ka evidencuar edhe bojkote për periudhën e raportimit 6-mujor në pjesën e parë të këtij viti.

"Gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha komitetet e KK-së janë bojkotuar nga PDK-ja, si partia më e madhe me numrin e këshilltarëve komunalë, si pasojë e pakënaqësisë me formulën e përfaqësimit të tyre nëpër komitete", ka thënë Krasniqi, derisa pakënaqësi për këtë fakt kishte shprehur në vazhdimësi edhe vetë Grupi i këshilltarëve të PDK-së në seancat e kaluara, duke kërkuar nga pozita përfaqësimit të drejtë në komitete sipas numrit të vendeve. Për më tepër, monitorimi ka nxjerrë edhe

aktivët dhe joaktivët në seanca të KK-së për 6 muaj. Sipas raportit, top treshja më aktive nga këshilltarët e kësaj legjislature për periudhën janar - qershor 2014 janë Florent Hoxha nga PDK-ja me 52 pikë, Blerim Gashi nga AKR-ja me 48 pikë dhe Arben Bahtiri nga "VV"-ja (nga seanca e muajit maj 2014 ka kaluar në radhët e LDK-së) me 46 pikë. Ndërsa top katërshen më pasive në KK për periudhën janar - qershor 2014 e përbëjnë dy femra e dy meshkuj, ndërsa LDK-ja ka më shumë të pasivizuar. Arton Retkoceri e Burbuqe Fazliu nga LDK-ja janë kuotuar me zero pikë, njësoj si edhe Burbuqe Ilazi nga PDK-ja dhe Rizah Bajraktari nga koalicioni AAK-LDD.

©KOHA Ditore